- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (Shtojca 12)

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqese kopje të balanceve të tre viteve të fundit (2017, 2018, 2019), të paraqitura pranë autoritetit përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet, ne të cilat duhet të rezultojë se nuk ka dal me humbje të pakten në dy vite të njepasnjeshëm si dhe të shoqëruara me akt ekspertizen e kryer nga Ekspert kontabel i autorizuar.

2.2.2 Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë tre viteve të fundit (2018, 2019, 2020), duhet të mos jetë më e vogël se 50% e fondit limit të procedurës së prokurimit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqese një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqese vërtetim lëshuar nga organet vendore për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitet 2018, 2019 dhe 2020, në vendet ku ushtron apo ka ushtruar aktivitet sipas QKB-së. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas QKB-së për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

2.2.4 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqese një vërtetim që nuk ka detyrime të cfardo lloji natyre pranë Autoritetit Kontraktor. Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej antareve të bashkimit duhet të paraqese vërtetimin e mesiperm.

2.3 Per Kapacitetin teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën

:

a. “Punë të ngjashme” për një objekt të vetëm **në një vlerë jo më të vogël se 50%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tre vitet të fundit nga data e zhvillimit të procedures së prokurimit.

ose

b. “Punë të ngjashme” ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedures së prokurimit është **në një vlerë jo më të vogël se** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

2.3.1.a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

- 1 Kontraten/at e Sipërmarrjes,
- 2 Situacion përfundimtare të objektit,
- 3 Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojces nr.9,
- 4 Akt Kolaudimi
- 5 Çertifikaten e marrjes ne dorezim.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj

2.3.1.b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm::

- 1 Kontraten/at e Sipërmarrjes,
- 2 Leja e ndërtimit
- 3 Situacion përfundimtare të objektit,
- 4 Faturat tatimore për çdo situacion,
- 5 Akti i Kolaudimit

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Operatorët ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë **license profesionale** për zbatim punimesh në ndertim si dhe në license disponojnë kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008; *Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi*”, i ndryshuar.

Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

a) Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- N.P.1- D** Punime gjërmimi në tokë.
- N.P.5 –C** Punime nëntoksore, ura e vepra arti.
- N.P.7 –D** Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje
- N.P.9 –C** Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime
- N.P.12-D** Punime të inxhinierisë së mjedisit.

b) Për punimet speciale të ndërtimit:

- N.S.4- D** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me infrastrukture druri, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndertuese.
- N.S.-8- D** Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
- N.S.16- A** Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij
- N.S.18- B** Punime topogjeodezike
- N.S.20- A** Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë nje punësim mesatar jo më pak se 75 punonjës me kohe te plote për periudhen Janar 2020 – Dhjetor 2020 e vërtetuar kjo me:

a.Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Janar 2020 – Dhjetor 2020.

b.Listë pagesat e punonjësve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Janar 2020 – Dhjetor 2020.

2.3.4 Stafi kryesor e mbështetës, punonjesit, çertifikimet

2.3.4.a) Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik ne licence e shoqërisë dhe të jenë të punësuar prane kesaj shoqërie 3 muajt e fundit, Inxhinierët e mëposhtëm:

Ing.Ndertimi	2 persona
Ing.Ndertimi (Strukturist)	1 person
Ing.Ndertimi (Gjeoteknike)	1 person
Ing. Ndertimit (Transport)	1 person
Urbanist	1 person
Ing.Mekanik,	2 person
Ing.Mjedisi,	2 persona (njeri profil trajtim ujrash)
Ing.Hidroteknik,	2 persona
Ing.Topograf,	1 person
Ing.Elektrik,	2 person
Ing.Gjeolog.	1 person
Ing. Elektronik, (Telekomunikacion)	1 person

Për inxhinieret e mësipërm duhet të paraqitet:

- a) Keta Inxhinierë duhet te jene te punesuar me kontrate pune me kohe te plote.
- b) Per Inxhinierat e mesiperm te paraqiten kontratat e punes, cv dhe diplomat e tyre. Si dhe te figurojne ne listepagesa.

2.3.4.b) Operatori ekonomik duhet te kete **te punesuar ne stafin e tij mbeshtetes** edhe:

- 1) nje inxhinier pyjesh**

- a. Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- b. Diplome

2) nje inxhinier agronom

- a. Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- b. Diplome

3) nje inxhinier informatik i paisur me license cisco

- a. Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- b. Certifikata e Vlefshme

4) nje restaurues nonumentesh ku te paraqitet:

- a. Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- b. Certifikata e Vlefshme

5) nje inxhinier kimist teknolog

- a. Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- b. Diplome

2.3.4.c) Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar punonjes te kualifikuar ne profesionet si me poshte:

• Teknik Hidraulik	1
• Teknik Mekanik	2
• Saldator	3
• Shofer	3
• Karpentier	3
• Hekurthyes	3
• Instalues i paisjeve hidrosanitare dhe ventiluse	1
• Teknik Ndertimi	4
• Teknik Topograf	1
• Specialist montues tubash HDPE	1

Per specialistet e kerkuar me siper te paraqiten diplome/deshmi/certefikate/ose cdo dokument tjeter qe verteton kualifikimin e tij si dhe kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit

2.3.4.d) Gjithashtu operatori ekonomik duhet te kete te punesuar dhe 8 manovratore nga të cilët:

- eskavatorist 4
- eskavatorist me goma, 2
- automakinist 1
- buldozerist 1

2.3.4.e) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt, te perfshire ne licensen e shoqerise dhe të deklarojnë se do të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

2.3.4.f) Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij **1(një) mjek** në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr.108, datë 9.2.2011 ” Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar),

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës e vlefshme
- Diplomë
- Urdhër Mjeku
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë minimalisht 3 muajt e fundit .

2.3.4.g) Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.(Në mbështetje të VKM Nr. 692 datë 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, Neni 12/1 Operatorët ekonomik pjesmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme.)

2.3.4.gj) Operatori/et ekonomik duhet te kete ne stafin e tyre personel te kualifikuar/çertefikuar edhe punonjësit e mëposhtëm:

- a) 1 (nje) Inxhinier Auditues Energjie (i paisur me certifikaten per auditimin e energjise),e leshuar nga shoqeria te akredituara ose nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
- b) 1 (nje) Inxhinier te jete kordinator sigurie ne fazen e zbatimit.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- c) 1 (nje) Inxhinier te disponoje certefikaten te trajnimit si “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune ne perputhje me klauzolat e ligjit Nr.10327 date 18/02/2010 Per sigurine dhe shendetin ne pune dhe VKM Nr.312 date 05.05.2010 “Per miratimin e rregullores” “Per sigurine ne kantier”.
- d) 1 (nje) inxhinier t ekspert zjarrfikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin deshmuar me kontrate pune dhe certefikata perkatese e dhene nga Drejtoria MZSH.
- e) 1 (nje) Inxhinier i cili te jete me certifikate dhe te kete perfunduar Kursin Baze te Ndihmes se Pare te zhvilluar nga KKSH.
- f) 1 (nje) Inxhinier i cili te jete “Pergjegjes per demet ne mjedis”,ne perputhje me klauzolat e ligjit Nr.10431 date 09.6.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit” me eksperience pune jo me pak se 3 vjet.
- g) 1 (nje) Inxhinier elektrik i cili te jete i paisur me certifikate per Sistemet e kontrollit dhe komandimit
- h) 2 (dy) Inxhinier te paisur me certefikaten “Pergjegjes per sigurimin dhe kontrollin e cilesise sipas Iso 9001:2015”

Per stafin e mesiperm te paraqiten:

- Kontrate Pune
- Te figuroje ne listpagesen e shoqerise.
- Diplomat dhe certefikatat perkatese.

2.3.4.h) Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Certifikatat që kërkohen duhet të jenë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

- Certifikate ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë)
- Certifikate ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit)
- Certifikate ISO 18001:2007 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë).
- Certifiakate PAS 99: 2012 (Sistemi i menaxhimit të integruar)
- Certifikate ISO 39001 : 2012 (Certifikate për sistemin e menagjimit të sigurisë në trafikun rrugor)

- Certifikate ISO 27001:2013 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit).
- Certifikate ISO 3834-2:2006 (Sistemi i cilësisë për saldimin e materialeve metalike)
- Certifikate ISO 50001:2011 (Sistemi i menaxhimit të energjisë).
- Certifikate ISO 1452-1-2009 (Sistemet e tubave të plastikës për furnizimin me ujë nën presion)
- Certifikate DS CEN/TR 15128-2005 (Çertifikatw e provës për të vlerësuar konformitetin në çelik, gize dhe alumin)
- Certifikate BS EN 13331-1 2002 (Pjesë të parafabrikuara, Metale, sisteme strukturore, masa sigurie, specifikim materialesh
- Certifikate ISO 45001:2018 (Siguria dhe shëndeti në punë)
- Certifikate ISO/IEC 20000-1:2011 (Çertifikatë për yeknologjinë e informacionit)
- Certifikate SA 8000:2014 (Sistemi i menaxhimit të përgjegjësisë shoqërore)

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatat ISO sipas zërave të preventivit të marrë përsipër për ti realizuar në marrveshjn e bashkëpunimit).*

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë:

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA Minimumi
1.	Kamiona me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	ne pronesi ose me qera	cope 2
2.	Kamiona me kapacitet mbajtes 10-20 ton	ne pronesi ose me qera	cope 3
3.	Kamion me vinc 6-7 vinc.	ne pronesi ose me qera	Cope 1
4.	Kamioncine 1-2 ton	ne pronesi ose me qera	cope 1
5.	Eskavator me Zinxhire	ne pronesi ose me qera	cope 4
6.	Minieskavator	ne pronesi ose me qera	cope 4
7.	Minifadrome	ne pronesi ose me qera	cope 2
8.	Eskavator me goma	ne pronesi ose me qera	cope 2
9.	Fadroma	ne pronesi ose me qera	cope 3
10.	Grejder	ne pronesi ose me qera	cope 1
11.	Mini Dumper	ne pronesi ose me qera	cope 1

Dokumenta Standarde të Tenderit

12.	Autobot uji	Ne pronesi ose me qera	cope 1
13.	Autobetoniere	Ne pronesi ose me qera	cope 1
14.	Autovinc	Ne pronesi ose me qera	cope 1
15.	Sond shpimi per pilota	ne pronesi ose me qera	Cope 1
16.	Sond shpimi per material shkembor 4000 m3/8h	Ne pronesi ose me qera	Cope 1
17.	Rrul gome hekur (kapaciteti jo me pak se 18 ton)	Ne pronesi ose me qera	cope 1
18.	Rrul gome hekur (kapaciteti jo me pak se 12 ton)	Ne pronesi ose me qera	cope 1
19.	Rrul hekur hekur (kapaciteti jo me pak se 8 ton)	Ne pronesi ose me qera	cope 1
20.	Vibratore	Ne pronesi ose me qera	cope 2
21.	Kompresor	Ne pronesi ose me qera	cope 2
22.	Betoniere me pompe betoni	ne pronesi ose me qera	cope 1
23.	Matrapik	ne pronesi ose me qera	cope 2
24.	Betoforma	ne pronesi ose me qera	500 m/l
25.	Impiant betoni	ne pronesi ose me qera	cope 1
26.	Makineri per ngjitje tubash	Ne pronesi ose me qera	cope 1
27.	Aparat per ngjitje elektrofuzive	Ne pronesi ose me qera	cope 1
28.	Paisje per matjen e presionit te tubave	Ne pronesi ose me qera	cope 1
29.	Aparature per testimin e ngjeshmerise se materialit me metode me goditje (pjate)	Ne pronesi ose me qera	cope 1
30.	Freze asfalti	Ne pronesi ose me qera	cope 1
31.	Gazogjen	Ne pronesi ose me qera	cope 1
32.	Gjeneratore	Ne pronesi ose me qera	cope 4
33.	Skeleri	Ne pronesi ose me qera	1500 m2

Te paraqiten dhe paisjet e mbrojtjes ne pune te puntoreve, personelit si me poshte:

- Kokore minimumi 30 cope.
- Fikese zjarri te levizshme me kapacitet 5-7 litra minimumi 8 cope.
- Prozhektore ndricimi naten minimumi 5 cope.
- Komplet i ndihmes se shpejte minimumi 8 cope.
- Tabela paralajmeruese per sigurine ne objekt minimumi 40 cope.

a) Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr. 10 dhe dokumentacioni si më poshtë: Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore, çertifikata e pronësisë së mjetit dhe foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

- b) Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore, certifikata e pronësisë së mjetit dhe foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit, duhet të shoqërohet me kontratën noteriale të qerave e lidhur për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- d) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- e) Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër të Kapacitetit Teknik do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjate afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak s'kualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
- f) Për fabrikën e betonit në rast se është në pronësi të firmës, duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe kontrata e qirasë (nëse është marrë me qira) ose kontratë furnizimi. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e këtyre dokumentave perben kusht për skualifikim.
- 2.3.6** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme : Kodi III.1.A. Leje mjedisore e tipit C.
- 2.3.7** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për transport të mbetjeve jo të rrezikshme: Kodi III.2.B.
- 2.3.8** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me license lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për vlerësimin e ndikimit në mjedis (auditim mjedisor) : Kodi III.2.A (1+2).
- 2.3.9** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me license lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shërbime ndërhjeshme higjieno- shëndetësore (Deratizim, Dezinfektim, Dezinsektim): Kodi II.8.B .
- 2.3.10** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me license lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shërbime të ekspertizës profesionale lidhur me pyjet dhe kullotat: Kodi III.7.A.
- 2.3.11** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me license lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shpues profesionist për ujë: Kodi III.7.B

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me license lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shërbime ekspertize, studim dhe përgatitje e projekteve mbi masat mbrojtëse nga zjarri: Kodi 1.2.A

2.3.13 Për të siguruar përqëndrimin e plotë të Kontraktorit në objekt, Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohej se, brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Sipas Shtojcës 11.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyruesisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj: **Sipas projekt zbatimit bashkëlidhur këtyre dokumenteve**

Specifikimet Teknike të Materialeve: **Sipas Specifikimeve Teknike dhe Relacionit Teknik bashkëlidhur këtyre dokumenteve.**

Grafiku i Punimeve: **Sipas Grafikut të Punimeve bashkëlidhur këtyre dokumenteve.**

Shënim: Oeratorët ekonomikë mund të ofrojnë një Grafik Punimesh alternativ, por në çdo rast afati i punimeve nuk do të jetë më i madh se 12 muaj.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Preventivi i punimeve jepet bashkëlidhur këtyre dokumenteve.

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____	_____
----------	-------

Dokumenta Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/ Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha

bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si

rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukuqe që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoritetit Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

